



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2023:160516

Datë: 15.04.2024

Numri i dokumentit: 05573632

C.nr.686/2023

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Berkan Hamza, me bashkëpunëtoreshen profesionale Adelina Çmega, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditësit I.G nga Rahoveci, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokate S.B nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokati B.O nga Rahoveci, me bazë juridike kompensimi i ushqimit në punë, vlera e objektit të kontestit 706.00 euro, jashtë seancës, më datën 15.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditësit I.G.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit I.G nga Rahoveci, në emër të kompensimit për ushqim në punë për periudhën kohore prej datës 21.01.2021 e deri më datën 21.11.2022 për 353 ditë pune të ja paguajë shumën prej 706.00 euro duke e llogaritur nga 2 euro për çdo ditë të prezencës në punë, me kamatë ligjore 8% nga data 25.07.2023 (data e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm.

III. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të shpenzimeve të procedurës, paditësit I.G, t'i paguajë shumën prej 124.00 euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësi I.G, më datën 25.07.2023, në këtë gjykatë ndaj të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, ka parashtruar padinë për kompensimin e ushqimit në punë në shumën prej 706.00 euro.

I njëjti sipas padisë ka theksuar se është në marrëdhënie pune në bazë të kontratës së punës në vendin e punës në SHMFU “Ardhmëria”, në Rahovec. Duke shtuar se për periudhën kohore nga data 21.01.2021 e deri më datën 21.11.2022, i takon kompensimi për ushqim në punë, për një

ditë pune shuma prej 2 euro, në bazë të nenit 35 par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë. Andaj, i ka propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë ta aprovojë në tërësi si të bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, në përgjigjen e saj në padi të datës 27.03.2024, ka theksuar se e kontestojmë padinë në tërësi për shkak se drejta për kompensim mbi bazën në të cilën janë thirrur palët paditëse është parashkruar. Paditësi ka ushtruar padi në gjykatë më 25.07.2023, me të cilën ka kërkuar kompensimin e shpenzimeve të ushqimit dhe udhëtimit, për periudhën kohore nga 21.01.2021 – 21.11.2022, me mbështetje në Kontratën Kolektive të Arsimit të datës 18.04.2017. Kërkesëpadinë e paditëses e konteston në tërësi edhe mbi bazën që më 21.11.2022 MASHT-i ka shkëputur Kontratën Kolektive të Arsimit të datës 21.01.2021 të lidhur me SBASHK. Duke shtuar se kërkesa në kuptim të nenit 87 të Ligjit të Punës, është parashkruar. Andaj i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj tërësisht si të pa bazuar ndaj të paditurës Komuna Rahovecit.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Për të vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë të plotë dhe të drejtë, gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave: vërtetimit me Nr. 785, i datës 08.06.2023, i lëshuar nga SHFMU “Gëzim Hamza - Piktori” në Rahovec.

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 dhe 398 të LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko-civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Nuk ishte kontestues fakti se paditësi ka të themeluar marrëdhënien e punës tek e paditura. Po ashtu nuk është kontestues as fakti se paditësi për periudhën e kërkuar kohore ka prezantuar në punë. Në këtë çështje juridike kontestues mbetet fakti se a i takon paditësit pagesa e ushqimit për çdo ditë të prezencës në punë, si dhe a është parashkruar e drejta për të kërkuar kompensimin e ushqimit.

Me administrimin e vërtetimit mbi ditët e prezencës në punë me 785, i datës 08.06.2023, gjykata vërtetoi faktin se paditësi I.G, në periudhën kohore prej datës 21.01.2021 e deri më datën 21.11.2022 ka prezantuar në punë në 353 ditët e punës.

Gjykata ka vendosur ta aprovojë kërkesëpadinë e paditësit për faktin se paditësit në periudhën kohore nga data 21.01.2021 e deri më datën 21.11.2022 në vendin e tij të punës ka prezantuar në 353 ditët e punës. Kjo është vërtetuar sipas vërtetimit të lëshuar nga vetë shkolla ku paditësi ka qenë duke punuar, ndërsa vërtetësinë e këtij dokumenti nuk e ka kontestuar as e paditura. Baza juridike e kërkesëpadisë buron në nenin 90 par.5 të Ligjit të Punës, ku parashihet se *“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”*. Ndërsa sipas nenit 35 par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 si dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021 parashihet që *“Të punësuarve, u sigurohet kompensimi*

për ushqim gjatë punës për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë për një ditë pune është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënie e punës primare në institucionet arsimore”. Në rast se shumëzohen 353 ditët e prezencës në punë me nga 2 euro të paditësit I.G, për secilën ditë të prezencës në punë, do të kemi shumën e përgjithshme prej 706.00 euro.

Sa i përket çështjes së parashkrimit, gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës për faktin se padia e paditësit është dorëzuar më datën 25.07.2023, ndërsa kërkesëpadia e paditësit përfshin periudhën kohore prej datës 21.01.2021 deri me datën 21.11.2022. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate baza juridike e parashkrimit të kërkesave në të holla në kontestet e marrëdhënies së punës është në nenin 87 të Ligjit të Punës, sipas të cilit “Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”. Prandaj edhe kërkesa është brenda afatit 3 vjeçar.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton se “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”.

Vendimin lidhur me kamatën në lartësi prej 8%, gjykata e mori në kuptim të nenit 382 të LMD-së, duke llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë.

Nga të lartcekurat, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 90 par.5 të Ligjit të Punës, nenit 2 par.1 pika 1.2 dhe neni 35 par.5 dhe par.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 si dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021, nenit 398 të LPK, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori në kuptim të nenit 449 dhe 452 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC

Departamenti i Përgjithshëm – Divizionin Civil

C.nr.686/2023, më datën 15.04.2024

Bashkëpunëtorja profesionale
Adelina Çmega

Gjyqtari
Berkan Hamza

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.